

MAMOGRAFIA MOBILE



Ardian Biçaku

Specialist Radiolog
Klinika e radiologjisë
SHSKUK

Mamografia mobile

Mamografia mobile, ose mamografia lëvizëse nënkupton ofrimin e shërbimit të ekzaminimeve mamografike që realizohen me aparat të njëjtë sikurse mamografët në institucionet shëndetësore ose mamografët statik, por që është i vendosur në automjetet lëvizës dhe përdoret për skringing të kancerit të gjirit (KGJ).

Mamografia mobile në Kosovë është inauguruar në Tetor të vitit 2014. Është iniciuar nga Grupi i Grave Deputete (GGD) të Legjislaturës së IV të Kuvendit të Kosovës në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit Jeta/Vita, të cilët kanë grumbulluar fondet për blerjen e njësisë së mamografit mobil të cilat janë siguruar nga donacionet nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare vendore dhe të huaja si dhe nga donatorët individual. Implementimi i shërbimit të mamografisë mamografisë mobile është realizuar përmes projektit “Ma-Mo 1” i cili është udhëhequr nga Diagnostika e Gjirit në Klinikën e Radiologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) deri në fund të vitit 2019. Për shkak të pandemisë, përkohësisht projekti i mamografisë mobile është ndërprerë dhe presim që të rifilloj së shpejti.

Nevoja për mamografi mobile

Shërbimi i mamografisë mobile është strategji për përmirësimin e dallimeve në qasje të femrave në skringing për KGJ, duke ofruar pa pagesë këtë shërbim në fshatra dhe në qytetet të cilat nuk kanë mamografi dhe në këtë mënyrë zvogëlon dallimet regionale në qasje për mamografi, eliminon shpenzimet si dhe zvogëlon barrierat e udhëtimit për këtë shërbim.

Nëse i referohemi të dhënave të mbulueshmërisë së Kosovës me mamografi në vitin 2014, në atë kohë, në sektorin publik kanë ekzistuar 11 kabinete të mamografisë por të kualitetit teknik dhe operacional si dhe të kapaciteteve kadrovike të kufizuara. Objektivat kryesore të projektit “Ma-Mo 1” kanë qenë që të ofrojë ekzaminime kualitative mamografike në regionet që nuk janë të mbuluara me këtë shërbim, të inkurajojë femrat për ekzaminim mamografik, të ngrit vetëdijësimin për detektim të hershëm për KGJ, dhe të mblidhen shënime mbi gjendjen aktuale të mamografisë dhe diagnostikimit të patologjive të gjirit në Kosovë. Gjithashtu, implementimi i këtij projekti ishte i koordinuar me objektivat e Programit Nacional për Kontroll të Kancerit.

Dinamika e mamografisë mobile

Implementimi i projektit “Ma-Mo 1” në regionet jashtë Prishtinës ka filluar në Shkurt të vitit 2015, dhe ka vazhduar deri në fund të vitit 2019, ndërsa për shkak të pandemisë, në bazë të rekomandimeve ndërkombëtare për mamografi në kohë të pandemisë, si dhe të Institutit Kombëtarë për Shëndetësi të Kosovës ky shërbim përkohësisht është ndërprerë.

Gjatë këtyre katër viteve mamografi mobil ka vizituar 34 komuna/lokalitete të ndryshme (nga 38 komuna sa janë në Kosovë), në përjashmim të komunës së

Pejëse e cila ka një shërbim kualitativ mamografik, si dhe tre komunave veriore të banuara kryesisht me popullatë jo-shqiptare/serbe (Mitrovicë, Leposaviq, Zveçan), ku realizimi i projektit me gjithë insistimin tonë nuk është arritur. Janë realizuar mbi 11000 mamografi ose rreth 5% të numrit të përgjithshëm të femrave të grupmoshës mbi 40 vjeçare (bazuar në regjistrimin e popullatës së vitit 2011). Me një organizim të mirëfilltë me autoritetet shëndetësore dhe komunale lokale, përmes këtij projekti janë ofruar shërbime mamografike të femrat nga rreth 600 fshatra të Kosovës, ndërsa nga numri i përgjithshëm i ekzaminimeve, 41% të femrave të ekzaminuara janë nga zonat rurale. Rreth 14% të femrave të ekzaminuara i takojnë nacionaliteve jo-shqiptare që tregojnë për gjithëpërfshirshmërinë e këtij projekti. Nga të dhënat tona, mbi 80% të femrave të moshës mbi 40 vjeçare në Kosovë nuk kanë bërë mamografi asnjëherë më parë. Kjo e dhënë shqetësuese do të duhej të fuqizonte përkrahjen e kampanjave mbi vetëdijësim të femrave për zbulimin e hershëm të KGJ dhe rolin që ka mamografia në këtë drejtim. Nga numri i përgjithshëm i ekzaminimeve, janë detektuar 109 raste të reja me KGJ.



Figura 1. Dita e parë e punës në terren. (në foto: Prof. Ilaz Bunjaku, inf. Zejnepe Paci, inf. Ganimete Canolli).

Deri në vitin 2017, shërbimi i mamografit mobil për kah numri i ekzaminimeve ka realizuar numrin më të madh të mamografive krahasuar me të gjitha kabinetet e mamografive statike në territorin e Kosovës dhe me të drejtë mund ta quajm si qendra më e madhe e mamografisë në Kosovë. Këtë epitet e “humb” pas realizimit të projektit “Ma-Mo 2” i cili përfshinë krijimin e qendrës referente për diagnostikë të gjirit në QKUK, e cila sot ofron të gjitha shërbimet imazherike për diagnostikë të gjirit (ultrazërin, mamografinë, rezonancën magnetike të gjirit) si dhe metodat diagnostike minimalisht invazive (biopsitë aspirative më gjilpërë të hollë – FNAB, core-needle biopsitë – CNB, lokalizimet me tel – Wire localization,

galaktografinë). Ky evolucion i projektit të mamografit mobil ishte i natyrshëm dhe i domosdoshëm për zhvillimin e mëtejshëm të diagnostikës së gjirit.

Numri i profesionistëve që janë angazhuar për të realizuar mamografinë mobile

Natyrë e punës në terren dhe lokalitete të ndryshme, si dhe specifikat e operimit të njësisë së mamografit mobil kërkojnë që përveç radiologut dhe teknikëve të radiologjisë, i nevojshëm është edhe stafi mbështetës që përfshinë shoferët për lëvizje të njësisë dhe ekipës së stafit shëndetësorë, si dhe ekipin e inxhinierëve të elektrikes për çështjet teknike në lokalitete të ndryshme. Në këtë projekt kanë qenë të angazhuar të gjithë radiologët e diagnostikës së gjirit, që përbën numrin prej 8 radiologëve, gjashtë teknik të radiologjisë të aftësuar për punë me aparaturën mamografike, si dhe shoferët dhe ekipa e inxhinierëve të elektrikes që janë angazhuar nga shërbimet e QKUK-së, ndërsa nga lokalitetet dhe komunat ku ka operuar mamografi mobil është kërkuar mbështetja me infermier për organizimin e çështjeve administrative. Organizimi i punës ditore është bërë në ekupe prej një radiologut, dy teknikëve të radiologjisë si dhe shoferit, ndërsa gjatë ndërrimit të lokalitetit apo kërkesave teknike në terren është angazhuar ekipi i inxhinierëve. Çdo ditë punë janë realizuar rreth 15 ekzaminime mamografike. Në disa komuna është angazhuar radiologu dhe tekniku i radiologjisë nga institucionet lokale shëndetësore, dhe kjo ka mundësuar shkëmbimin e përvojave profesionale si dhe edukimin profesional të teknikëve lokal për punë me mamografi.

QKMF Fushë Kosovë 2016.

Mamografët mobil në Kosovë

Aktualisht në Kosovë ekziston vetëm një njësi e mamografisë mobile. Mirëpo, përvojat e punës së mamografisë mobile dhe të dhënat e mbledhura mbi gjendjen në terren, në disa komuna kanë ndikuar në iniciimin e procedurave të sigurimit të mamografëve statik për Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe spitale regionale. Për dallim nga viti 2014, sot në Kosovë janë 15 mamograf statik në komuna të Kosovës në shëndetësi primare dhe sekondare të cilët janë operacional nga aspekti teknik dhe kadrovik. Suksesi i projektit të mamografisë mobile ka bërë impakt revolucionarë tek vendimëmrërsit në mbështetje të projekteve për të siguruar mamograf statik. Për hir të historikut të mamografisë në Kosovë, do të përmendi që mamografia e parë në Kosovë është realizuar me 8 Mars të vitit 1985.

Grupmosha që i nënshtrohet kësaj procedure

Femrat e moshës mbi 40 vjeçare duhet të bëjnë skringing mamografi çdo vit, këto janë dhe rekomandimet e grupit punues të Programit Nacional për Zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit në kuadër të Bordit Nacional për Kontrollë të Kancerit të Ministrisë së Shëndetësisë i cili është përpiluar në bashkëpunim me organizatën Action for Mothers and Children (AMC). Për të kuptuar kriteret e veçanta për mamografi, së pari duhet të dallojmë mamografinë skringing nga mamografia diagnostike. Derisa mamografia skringing bëhet në mënyrë rutinore për zbulimin e hershëm të KGJ te femrat të cilat nuk ka ndonjë simptom të dyshimtë, mamografia diagnostike bëhet në rastet kur pacienti ka ankesa dhe simptome apo shenja klinike për sëmundje të gjirit ose pasi që në mamografinë skringing hasen të gjetura suspekte. Vlerësimi me mamografi diagnostike përfshinë projeksione shtesë mamografike si dhe aplikim të metodave tjera plotësuese imazherike si ultrazërin dhe rezonacën magnetike të gjirit. Skringing mamografia mund të bëhet edhe të grup-mosha 30-40 vjeçare në rastet kur kanë anamnezë familjare pozitive, pra anëtarë të familjes së



ngushtë (motra, nëna) me KGj të diagnostikuara para moshës 50 vjeçare dhe vlen rregullisht i “10 vjetëshit”, pra nëse familjari i saj është diagnostikuar në moshë 43 vjeçare, ajo mund të fillojë skringun nga moshë 33 vjeçare (10 vite më herët). Skringing mamografia nuk aplikohet te femrat në laktacion dhe te shtatzënat. Skringing mamografia unilaterale aplikohet dhe te femrat që kanë pasur mastektomi kontralaterale, ndërsa nuk aplikohet te rastet me lumpektomi apo pas trajtimit me radioterapi – këto raste do të vlerësohen me mamografi diagnostike dhe metoda plotësuese imazherike. Femrat me implante në gjinjë i nënshtrohen projeksione të veçanta mamografike andaj duhet të koordinohen për mamografi diagnostike dhe metoda tjera imazherike.

Skringing mamografia nuk bëhet te femrat nën moshën 40 vjeçar për shkak të densitetit të lartë të parenkimës së gjirit në këto moshë. Densiteti i lartë ulë sensitivitetin e mamografisë në detektim të KGj.

Në situatat kur evidentohen simptome të KGj përveç mamografisë diagnostike aplikohen edhe metodat tjera imazherike (ultrazëri, rezonanca magnetike e gjinjëve).

Shkalla e mbulimit të territorit të Kosovës me mamografi mobile

Mamografi mobil si njësi e vetme nuk është i destinuar për mbulimin e tërë territorit të Kosovës, por do të ishte i përshtatshëm për mbulimin e zonave ku nuk ka mamograf statik për momentin, dhe gjithashtu për shkak të lëvizshmërisë së kësaj njësie, do të mund të shfrytëzohej si njësi shtesë në kapacitetet ekzistuese, nëse do të planifikohet pilotimi i skringingut të kancerit të gjirit në ndonjë regjion më vogël. Numri i mamografëve për milion banorë, në Kosovë, është rreth 8.3, ndërsa në vendet e Evropës, sipas OECD (Organisation for Economic Co-operation and Development) në vitin 2018, p.sh.: Sllovenia ka 14.9, Austria 21.5, ose Italia 33.8 mamograf për milion banorë.

Sfidë tjetër në ofrimin e shërbimit të mamografisë në tërë territorin e Kosovës është stafi dhe përgatitja profesionale në lëminë e diagnostikës së gjirit e radiologëve dhe teknikëve të radiologjisë. Diagnostika e gjirit në Klinikën e Radiologjisë në QKUK, në bashkëpunim me spitalet regjionale dhe QMF që janë pajisur me mamograf, në vazhdimësi gjatë këtyre viteve ka ofruar trajnime për teknik të radiologjisë dhe radiolog për edukim profesional në këtë drejtim.

Duke u bazuar në sfidat e lartcekura, është përpiluar projekti “Ma-Mo 3”, si vazhdimësi e dy projekteve paraprake, i cili është orientuar në vlerësimin e fizibilitetit të qendrave ekzistuese për ofrimin e shërbimit të mamografisë, në kuptim të aparaturës dhe stafit ekzistues, si dhe planifikimin e nevojave për këto dy pika, i cili është realizuar pjesërisht, dhe orientimi tjetër është në vlerësimin e mundësisë së telemamografisë, që nënkupton leximin e mamografive në largësi përmes internetit. Telemamografia është pilotuar gjatë viteve 2017-2018, ku janë përfshirë Komuna e Gjakovës dhe njësi e mamografisë statike në QMF të Gjakovës, Qendra Kombëtare e Telemjekësisë (QKT) si dhe Diagnostika Gjirit në QKUK. Përmes këtij pilotimi, mamografitë janë realizuar në QMF të Gjakovës, ndërsa janë lexuar

nga radiologët në Diagnostikën e Gjirit të Klinikës së Radiologjisë. Për dy vite me radhë janë realizuar rreth 2000 mamografi. Sot, telemamografia me Komunën e Gjakovës ende funksionon, por jo në formatin e mëparshëm institucional. Rezultatet tona tregojnë që me një organizimin të tillë, e posaçërisht pas përvojave gjatë pandemisë ku shumë profesioneve iu është mundësuar puna në largësi përmes internetit, telemamografia është e përshtatshme të aplikohet dhe mund të zbus mungesën e radiologëve të profiluar në këtë fushë në QMF dhe Spitale Regjionale. Gjithashtu, kjo do të mundësonte krijimin e databazës elektronike të mamografive e cila do të ishte shumë e rëndësishme në ruajtjen elektronike të imazheve mamografike, përcjelljen/krahasimin e tyre gjatë viteve, si dhe vlerësimin e opinioneve sekondarë të të gjeturave imazherike/patologjive të gjirit përmes bashkëpunimit në nivel kombëtar, e ndoshta dhe ndërkombëtarë.

Efektet e dëshirueshme të zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit

Efekt kryesor i pritshëm është ulja e mortalitetit na kjo sëmundje, që arrihet përmes mamografisë në detektimin e hershëm të kancerit të gjirit. Qëllimi kryesor i mamografisë është në detektimin e hershëm të KGj, që në fazat fillestare kur ende nuk kemi shenja/simptome klinike. Zbulimin e hershëm, nënkupton shërim të plotë, trajtim më të përshtatshëm për pacientin, dhe zvogëlim të kostos së trajtimit në përgjithësi.

Përkrahja institucionale për mamografinë mobile

Përkrahja institucionale për mamografinë mobile në veçanti, si dhe për diagnostikën e gjirit në përgjithësi nuk ka munguar. Duhet të falënderojmë GGD, të cilët janë dhe përfaqësues tonë në Kuvend të Kosovës dhe Qeveri të Kosovës ndër vite. Tre projektet e lartcekura (Ma-Mo 1, Ma-Mo 2, dhe Ma-Mo 3) kanë pasur mbështetje të institucioneve. Kostot e funksionimit të projektit Ma-Mo 1 (njësia e mamografisë mobile) tani është i mbështetur nga buxheti i SHSKUK/QKUK. Projekti Ma-Mo 2 tani është pjesë e Diagnostikës së Gjirit në Klinikën e Radiologjisë në QKUK. Projekti Ma-Mo 3, segmenti i telemjekësisë, në aspektin teknik ka qënë i mbështetur nga QKT, ndërsa sa i përket vlerësimin të fizibilitetit të mamografëve statik në QMF dhe Spitale Regjionale, jemi faza e planifikimit është e gatshme. Në vitin 2016 është krijuar Seksioni i Imazherisë së Gjirit në kuadër të Shoqatës së Radiologëve të Kosovës i cili është përgjegjës për krijimin e standardeve të kualitetit të mamografisë në veçanti dhe procedurave diagnostike dhe algoritmeve diagnostike për KGj në përgjithësi, por nevojitet bashkërendimi institucional në të ardhmen për miratimin e këtyre standardeve.